



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit  
Opština Gnjilane  
Municipal Gjilan  
Gilan Belediyesi

---

## D R E J T O R I A P Ë R B U J Q Ë S I D H E P Y L L T A R I

### RAPORT I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR, 2010

#### 1. PROJEKTI PËR TRAJNIME DHE KËSHILLA PROFESIONALE - “Heifer-2010”

Vlera e këtij projekti është 16.000,00 \$. dhe paraqet 20% të vlerës së projektit për lopët qumështore të realizuar mes Organizatës “**Heifer**” dhe Drejtorisë së Bujqësisë në vitin 2009. Këto të holla do të duhej të participonte Komuna jonë sipas Memorandumit të Bashkëpunimit mes Komunës dhe Org.”Heifer”.

Pas negociatave me drejtorin e “Heiferit” arritëm marrveshje që në vend se ti paguaj Komuna këto të holla, ne (Drejtoria e Bujqësisë) të organizojmë trajnimet dhe monitorimin e projektit, sipas planit të paraparë nga Organizata Heifer.

#### 2. SEMINAR PËR FORMIMIN PROFESIONAL TË BLEGTORËVE -2010

Është një cikël seminaresh që do të mbahen në komunën tonë në bashkëpunim me ekspertët e Organizatës Austriake “**A M A K O**”.

Janë mbajtur tre seminare. Deri në fund të këtij viti do të mbahen edhe disa të tilla. Qëllimi i këtyre seminareve është ngritja e kapaciteteve profesionale të fermerëve tanë, duke marrë përvojë nga ekspertët Austriak, si kusht për arritjen e suksesit në fermat e tyre.

#### 3. PROJEKTI PËR VIZITA STUDIMORE TË FARMERËVE NËPËR KOSOVË

Me që në disa qendra të Kosovës egzistojnë ferma shumë të suksesshme, në bashkëpunim me Organizatën “**MercyCorps**”, kemi organizuar disa vizita të tilla si ajo në Deqan, Viti, etj. ku kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i fermerëve të komunës së Gjilanit. Qëllimi i këtyre vizitave është këmbimi i përvojave të mira mes fermerëve.

#### 4. KËSHILLA PRAKTIKE PROFESIONALE

Me qëllim të aftësimit profesional të fermerëve, Drejtoria ka organizuar disa këshillime me fermerët e fshatrave të ndryshme si: Capar, Bukovik, Stublinë, Sllubicë, Bilinicë.

Këto trajnime janë realizuar **nga ekspertët e Drejtorisë së Bujqësisë**, si dhe një trajnim me fermerët nga gjitha fshatrat e komunës, të organizuar në Restorantin “Lura” në bashkëpunim me **Prof. Dr. Behlul Behluli**.

## 5. LIKUIDIMI I QENËVE ENDACAK

Edhe pse gjat vitit 2008-2009, janë organizuar 4 aksione për zvoglimin e numrit të qenëve endacak, dhe janë likuiduar mbi 2000 qenë të tillë, në fillim të këtij viti u shtua numri i ankesave të qytetarëve për rrezikun nga qentë endacak.

Me që nuk kishim fonde për të paguar një aksion të ri, u detyruam të negociojmë me shoqatat e gjuetarëve të komunës së Gjilanit dhe arritëm që të organizojmë një aksion, gratis, për eliminimin e qenëve endacak.

Aksionin e realizoi Shoqata e Gjuetarëve “U j k u” dhe u likuiduan 554 qenë.

## 6. FAZA E DYTË E PROJEKTIT TË ORGANIZATËS “Heifer” PËR PASIMIN E DHURATËS

Me 24.04.2010, në fshatin Caparë u realizua një pjesë e fazës së dytë të projektit të Organizatës “Heifer” që ka të bëjë me pasimin e dhuratës (një mështjerre) nga fermerët që kanë përfituar vitin e kaluar lopë qumështore te fermerët tjerë.

Me këtë rast përfituan edhe 5 familje të varfëra nga një lopë qumështore.

## 7. PROJEKTET PËR MBJELLJET PRANVERORE – 2010

Vlera e përgjithshme e këti projekti është 15.000,00 €.

U është dhënë gratis farë misri, farë jongje dhe foli plastike.

Kanë përfituar gjithsej 570 fermer.

## 8. CIKËL I KËSHILLIMEVE PROFESIONALE (blegtori, pemëtari, perimkulturë)

Gjat muajit maj, janë organizuar tri këshillime dhe do të vazhdojmë me këshillime të tilla gjat tërë vitit. Qëllimi është që fermerët të kenë informacione sa më profesionale në të gjitha fazat e zhvillimit të prodhimtarisë bujqësore, që të ndër marrin masa të nevojshme, si për kultivimin ashtu edhe për mbrojtjen e prodhimtarisë nga sëmundjet dhe dëmtuesit

## 9. PROJEKTI PËR SUBVENCIONE PËR LOPËT QUMËSHTORE

Është realizuar në bashkëpunim me MBPZHR-në. Drejtoria ka informuar të gjithë fermerët për projektin, ka ndihmuar në përgaditjen e dokumentacionit të nevojshëm pranimin e aplikacioneve dhe verifikimin e kafshëve në teren.

Vlera e projektit ka qenë 49.050,00€

Kanë përfituar 260 fermer

#### 10. PROJEKTI PËR SUBVENCIONE PËR KAFSHË TË IMËTA

Është realizuar në bashkëpunim më MBPZHR-në. Drejtorja ka informuar të gjithë fermerët për projektin, ka ndihmuar në përgaditjen e dokumentacionit të nevojshëm pranimin e aplikacioneve dhe verifikimin e kafshëve në teren.

Vlera e projektit ka qenë ?

Kanë përfituar ? fermer

11. Jemi duke u përgaditur për ushtrimin e kompetencave të reja, në harmoni me Ligjin për Qeverisje Lokale. Nga muaji korrik do marrim kompetenca edhe për mbrojtjen e pyjeve.

Gjilan, 31.06.2010

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari  
*Ing.i dipl.Nazmi Rapuca*